

PERFORMANCA
DHE NDIKIMI I
KËSHILLIT
KONSULTATIV PËR
KOMUNITETE

2015-2016



Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Kosovë

PERFORMANCA
DHE NDIKIMI I
KËSHILLIT
KONSULTATIV PËR
KOMUNITETE

2015-2016

TABELA E PËRMBAJTJES

LISTA E SHKURTESAVE	3
PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE	4
1. HYRJE	5
1.1 Metodologjia	6
2. KUADRI LIGJOR	6
3. PËRBËRJA	7
VEPRIMTARIA DHE NDIKIMI I PUNËS SË KKK–SË.....	8
4.1 Komunikimi me komunitete	8
4.1.1 Nivelet e vetëdijes së KKK–së dhe anëtarëve të tij.....	9
4.1.2 Vlerësimi i punës së KKK–së	11
4.2 KKK si lidhje mes komuniteteve dhe institucioneve të Kosovës.....	12
4.2.1 Institucionet me anëtarësi të përhershme në KKK.....	12
4.2.2 Si reagojnë institucionet ndaj rekomandimeve të KKK–së.....	13
4.3 Komentimi për iniciativat legjislative dhe të politikave	14
4.4 Pengesat në përmirësimin e funksionimit, fuqisë dhe ndikimit të KKK.....	15
4.4.1 Mendimet e përfaqësuesve të komuniteteve në KKK.....	15
4.4.2 Mendimet e anëtarëve të përhershëm që përfaqësojnë institucionet në KKK.....	16
5. PËRFUNDIME.....	17
6. REKOMANDIME	18
Shtojca 1. Rekomandimet e dërguara për institucionet	20

LISTA E SHKURTESAVE

KiK	Kuvendi i Kosovës
KK	Komiteti për Komunitete
KKK	Këshilli Konsultativ për Komunitete
OPK	Shoqatë/Organizatë që i përfaqëson komunitetet
KDIKK	Komiteti për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim
MKK	Ministria për Komunitete dhe Kthim
ZÇK	Zyra për Çështje të Komuniteteve
OSBE	Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë
RTK	Radio Televizioni i Kosovës

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Këshilli Konsultativ për Komunitete është organ i themeluar në kuadër të autoritetit të Presidentit, për të ofruar forum për shkëmbim të rregullt ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve. Funksionimi i tij i duhur është jetik për të siguruar që pikëpamjet e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në lidhje me legjislacionin, politikat publike dhe programet e rëndësishme të veçantë për to janë artikuluar dhe marr në konsideratë nga institucionet.

Qëllimi kryesor i këtij raporti është që të vlerësoj respektimin nga ana e Këshilli Konsultativ për Komunitete të kornizës ligjore që e rregulloj punën dhe funksionet e tij si dhe të identifikoj dhe theksoj çfarëdo mangësie apo pengese që duhet të tejkalohet në mënyrë që ky mekanizëm të jetë më efektiv dhe ta rritë pjesëmarrjen e komuniteteve në vendimmarrje. Raporti paraqet vlerësim të shkurtër të dy roleve themelore të Këshillit Konsultativ për Komunitete: për të siguruar lidhje ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve të Kosovës; dhe për ta shqyrtuar projekt legjislacionin dhe politikat para miratimit të tyre nga qeveria, dhe për të siguruar që pikëpamjet e komuniteteve janë marr para sysh. Raporti i vlerëson këto dy aspekte të rolit të KKK-së për periudhën janar 2015–dhjetor 2016, që mbulon pjesë të mandateve të dy përbërjeve të KKK-së (gusht 2014 – shtator 2016 dhe shtator 2016 – shtator 2018).

Raporti vë në pah që gjatë periudhës raportuese është arritur përparim në disa çështje. Në veçanti, raporti tregon përmirësime në pjesëmarrjen e anëtarëve në takimet e rregullta të KKK-së komunikimet ndërmjet anëtarëve të KKK-së dhe Sekretariatit të KKK-së si dhe komunikimin ndërinstucional në veçanti me Zyrën e Presidentit si dhe shkëmbimin e informatave ndërmjet vetë anëtarëve të KKK-së Mirëpo, raporti gjithashtu i thekson disa nga sfidat me të cilat është ballafaquar KKK gjatë periudhës së vlerësuar. Për sa i përket lidhjeve ndërmjet KKK-së dhe komuniteteve që anëtarët e saj përfaqësojnë, gjetjet nga ky hulumtim janë që niveli i ndërgjegjësimit të përfaqësuesve të komuniteteve në nivel komunal është në përgjithësi i ulët. Ky nivel i ulët i ndërgjegjësimit tregon që ka mungesë të kontaktimit e informimit në terren nga KKK dhe konsultimit të rregullt të komuniteteve në lidhje me legjislacionin, politikat dhe programet publike të rëndësishme për komunitetet. Për sa i përket vlerësimit të lidhjes ndërmjet KKK-së dhe institucioneve të Kosovës, çështjet që ndërlidhen me emërimin dhe pjesëmarrjen e anëtarëve të cilët përfaqësojnë institucionet me anëtarësi të përhershme në KKK, efektin në ndërgjegjësimin dhe ndikimin e KKK-së në këto institucione. Gjatë periudhës së raportimit KKK-ja ka mbajtur mbledhje të rregullta, i ka shqyrtuar shumicën e projektligjeve që i ka pranuar, dhe ka dërguar rekomandime në lidhje me të drejtat e komuniteteve në 18 institucione të nivelit qendror dhe komunal. Mirëpo, të dhënat nga hulumtimi tregojnë që ndikimi gjatë kësaj periudhe kohore ka qenë i kufizuar. Andaj, OSBE-ja i bënë thirrje KKK-së që të bëjë aktivitete të rregullta dhe të gjëra të kontaktimit e konsultimit me komunitete në terren, ashtu që të rritet niveli i ndërgjegjësimit në lidhje me këtë mekanizëm të rëndësishëm të nivelit qendror dhe të forcohet niveli i ndikimit të tij; Sekretariatit të KKK-së që të ofroj ndërtim të nevojshëm të kapaciteteve për anëtarët e KKK-së, në veçanti për sa i përket detyrave kryesore të komentimit të projekt-legjislacionit; dhe zyrës së Presidentit që të siguroj që buxheti i KKK-së është adekuat për kryerjen e të gjitha detyrave që i ka në mandatin e saj.

Për më tepër, OSBE-ja i bënë thirrje institucioneve që t'i përmbushin obligimet e tyre ligjore për sa i përket reagimit dhe adresimit të rekomandimeve të bëra nga KKK me kohë. Përveç kësaj, OSBE kërkon nga institucionet me anëtarësi të përhershme në KKK të emërojnë përfaqësues të cilët marrin pjesë rregullisht në takimet e KKK-së dhe ofrojnë lidhje të fortë ndërmjet KKK-së dhe institucionit të tyre përkatës. OSBE mbetet e përkushtuar për të ofruar mbështetje për KKK-

në në trajtimin e sfidave me të cilat ballafaqohet si dhe ngritjen e kapaciteteve të anëtarëve të tij në lidhje me çështjet specifike të cekura në raport.¹

1. HYRJJE

Këshilli Konsultativ për Komunitete (KKK) është mekanizëm i nivelit qendror që është krijuar në vitin 2008 (por ka filluar të punoj në vitin 2009) për të funksionuar si lidhje kryesore ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë së Kosovës si dhe institucioneve tjera relevante. Përbëhet kryesisht nga anëtarë/përfaqësues të komuniteteve joshqiptare në Kosovë, por përfshin edhe përfaqësues të institucioneve të caktuara të nivelit qendror që kanë mandat për të adresuar çështjet veçanërisht brengosëse për komunitetet. Si i tillë, Misioni në Kosovë i OSBE-së e ka monitoruar rregullisht punën e KKK-së që nga themelimi i tij (në veçanti duke marr pjesë në seancat plenare dhe takimet e grupeve punuese).

Qëllimi kryesor i këtij raporti është që ta vlerësoj respektimin e kornizës ligjore që e rregullon punën dhe funksionet kryesore të tij nga ana e KKK-së, si dhe të identifikoj e theksoj ndonjë mangësi apo pengesë që duhet tejkaluar në mënyrë që ky mekanizëm të jetë më efektiv dhe ta rrisë pjesëmarrjen e komuniteteve në vendimmarrje. Ky raport e adreson përbërjen, performancën dhe ndikimin e KKK-së gjatë periudhës 1 janar 2015 deri 31 dhjetor 2016. Kjo periudhë raportuese i mbulon dy mandatet e KKK-së: gusht 2014 – shtator 2016 dhe shtator 2016 – shtator 2018.² Si e tillë, shumica e periudhës raportuese (janar 2015 – shtator 2016) e vlerëson mandatin e kaluar të KKK-së, ku vetëm tremujori i fundit i vitit 2016 e vlerëson punën e mandatit aktual.

Vlerësimi përqendrohet në dy funksione që janë cekur shprehimisht në Kushtetutë: p.sh. së pari për të shërbyer si lidhje ndërmjet komuniteteve dhe institucioneve të Kosovës (që do të vlerësohet në këtë raport për sa i përket nivelit të komunikimit ndërmjet KKK-së dhe komuniteteve që i përfaqëson, si dhe ndërmjet KKK-së dhe institucioneve të Kosovës); dhe së dyti për të rishikuar projekt-legjislacionin dhe politikat para se ato të miratohen nga qeveria dhe për të siguruar që pikëpamjet e komuniteteve të merren në konsideratë³.

¹ Gjatë gjithë periudhës 2014 -2017, OSBE-ja e ka mbështetur KKK-në me tryeza dhe takime të ndryshme që janë mbajtur së bashku me institucionet e nivelit qendror dhe lokal për çështjet si përdorimi i gjuhëve pjesëmarrja në vendimmarrje, shkathhtësitë e hartimit ligjor. Në vitin 2017, OSBE e ka mbështetur KKK-në në organizimin e dy takimeve për adresimin e mangësive dhe zbrazëtirave të identifikuar në komunikim dhe bashkëpunim ndërmjet KKK-së dhe mekanizmave lokalë për përfaqësim të komuniteteve. Rekomandimet nga këto takime kanë ofruar propozime konkrete për përmirësimin e referimit të çështjeve komunale në KKK dhe forcimin e avokimit.

² Sipas nenit 12.8 të Ligjit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë, anëtarët e KKK-së emërohet për mandate dyvjeçar, shënimi më lartë 10

³ Neni 60 I Kushtetutës e përshkruan mandatin e KKK-së si vijon: "(1) ofrimin e një mekanizmi për shkëmbimin e rregullt ndërmjet komuniteteve dhe Qeverisë së Kosovës; (2) mundësinë e komuniteteve për të komentuar në një fazë të hershme nismat legjislative dhe politike, të cilat mund të përgatiten nga Qeveria, për të sugjeruar nisma të tilla dhe për të kërkuar që pikëpamjet e tyre të përfshihen në projektet dhe programet përkatëse; (3) çdo përgjegjësi a funksion tjetër, në pajtim me ligjin".

1.1 Metodologjia

Të dhënat për këtë vlerësim janë përfituar nga pyetësorët kualitativ me anëtarët aktual dhe të mëparshëm të KKK-së⁴, si dhe përfaqësuesit e sekretariatit të KKK-së të realizuar maj dhe qershor 2017. Ekipi hulumtues i ka intervistuar nëntë përfaqësuesit e organizatave përfaqësuese të komuniteteve (OPK)⁵ të akredituara në Zyrën e Presidentit, dhe akterët kryesor të KKK-ve, si ish kryesuesin dhe kryesuesin aktual, përfaqësuesit e institucioneve që kanë anëtarësi të përhershme në KKK, si dhe kryesuesin e Komitetit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim (KDIKK),⁶ të gjitha të realizuara gjatë muajit maj dhe qershor 2017.⁷ Një pyetësor shtesë është dorëzuar nga ekipet e OSBE-së në terren në maj të vitit 2017 në 34 komuna ku komunitetet në pakicë numerike kanë përfaqësues në Komitetet për Komunitete (KK) me informatat e pranuar nga përfaqësuesit e KK-ve.⁸ Secili institucion që ka pranuar rekomandim nga KKK gjatë periudhës raportuese është kontaktuar gjithashtu dhe anketa është bërë me kontaktet relevante në secilin institucion në korrik të vitit 2017. Të dhënat dytësore për punën e KKK-së gjatë periudhës raportuese janë nxjerrë gjithashtu nga analiza e raporteve vjetore të KKK-së, planet përkatëse të punës dhe publikimet e raportet tjera të KKK-së.

2. KUADRI LIGJOR

Themelimi i Këshillit Konsultativ për Komunitete garantohej me Kushtetutë⁹ si dhe me Ligjin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre (në tekstin e mëtutjeshëm Ligji).¹⁰ Hollësi të mëtutjeshme për përbërjen akreditimin e organizatave të komuniteteve që nominojnë anëtarë si dhe funksionet e KKK-së mund të gjenden në Ligj.¹¹ Buxheti për KKK është i përfshirë në kuadër të buxhetit për Zyrën e Presidentit dhe neni 26 i Statutit i parasheh funksionet specifike të KKK-së që duhet të mbulohej nga ky buxhet.¹² KKK

⁴ Me nga një përfaqësues të secilit komunitet të përfaqësuar në KKK si dhe kryesuesit për të dy përbërjet. (gusht 2014 – shtator 2016 dhe shtator 2016 – shtator 2018).

⁵ Për t'u bërë përfaqësues i akredituar i organizatës përfaqësuese të komunitetit, shoqata ose organizata joqeveritare duhet t'i përmbush kriteret e numëruara në nenin 7 të Statutit të KKK-së (shih shënimin 10), përfshirë demonstrimin që: përfaqëson një komunitet të vetëm (apo një koalicion të komuniteteve në përfaqësim të përbashkët), është regjistruar si OJQ në bazë të ligjit në fuqi, dhe mund të demonstroj historikun e punës në dobi të komunitetit që kërkon ta përfaqësoj. Lista e OPK-ve të akredituara që duhet të intervistohen është zgjedhur në konsultim me Sekretariatit e KKK-së si dhe është kontrolluar me ekipet e OSBE-së në terren. Për qëllim të këtij raporti, OSBE-ja e ka intervistuar nga një OPK për secilin komunitet.

⁶ Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim (KDIKK) është komision i përhershëm në Kuvendin e Kosovës. Roli i tij është që të siguroj se të drejtat dhe interesat e komuniteteve përfaqësohen në mënyrë adekuate nga Kuvendi i Kosovës, siç është theksuar në nenin 78 të Kushtetutës (shih shënimin 9).

⁷ Nuk ka shoqata/organizata të akredituara të komuniteteve që e përfaqësojnë komunitetin ashkali të Kosovës as në përbërjen e kaluar e as në atë aktuale të KKK-së. Përveç kësaj, përfaqësuesit e dy organizatave që e përfaqësojnë komunitetin kroat të Kosovës tashmë janë intervistuar në cilësinë e tyre si përfaqësues të KKK-së andaj edhe nuk janë përfshirë në këtë aspekt të mbledhjes së të dhënave.

⁸ Komitetet për komunitete janë mekanizma komunalë me mandate për të siguruar që të drejtat dhe interesat e komuniteteve të respektohen përmes rishikimit dhe ofrimit të rekomandimeve mbi politikat dhe veprimet komunale. KK-të përbëhen kryesisht nga përfaqësues të komuniteteve që jetojnë në komunë. Për mbledhje të të dhënave, janë intervistuar deri katër përfaqësues që l përfaqësojnë komunitetet më të mëdha në pakicë numerike që banojnë nëpër komuna; ishte e mundshme që t'i kemi nga dy gra dhe dy burra për komunë. Pasi që përbërja e KKK-së i përfshinë vetëm komunitetet në pakicë numerike në mbarë Kosovën, nuk ka përfaqësues të komunitetit shqiptar në KKK. Andaj, nuk është intervistuar asnjë përfaqësues i KK-së nga ky komunitet, qoftë edhe në komunat ku ata përbëjnë komunitet në pakicë numerike. Në anën tjetër, përfaqësuesit e komunitetit serb dhe turk të Kosovës si përfaqësues të KK-ve janë intervistuar edhe në komunat ku ata përbëjnë komunitet në shumicë numerike. Pasi që nuk ka përfaqësues joshqiptar të KK-ve në Glllogoc, Han të Elezit, Junik apo Kaçanik, këto katër komuna nuk janë përfshirë në mbledhjen e të dhënave.

⁹ Shih Kushtetutën, 15 qershor 2008, neni 60.

¹⁰ Ligji nr. 03/L-047 për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë, neni 12, 13 mars 2008, http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/2008_03-L047_en.pdf (e qasur më 13 mars 2017).

¹¹ Dekreti për miratimin e statutit të këshillit konsultativ për komunitete, dekreti presidencial nr. No.KKK-001-2012, 18 prill 2012.

¹² Shënim sipër 11. Funksionet specifike që duhet t'i mbuloj buxheti, sipas këtij neni të Statutit janë: organizimi dhe udhëheqja e takimeve të Këshillit; b. Mëditjet për anëtarët; c. Shpenzimet e komunikimit; d.shpenzimet për faqe të internetit dhe mirëmbajtjen e saj; e. Materialet dhe dokumentacioni për të mbështetur punën e KKK-së; f. Rekrutimi dhe mbajtja e personelit; g. Bërja e studimeve dhe anketave; h. Kërkimi i këshillave nga ekspertë të jashtëm; i. Ndërtim i kapaciteteve të këshillit dhe anëtarëve të tij; dhe publikimi i punës së KKK-së.

mund të vlerësohet edhe për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën ndërkombëtare për sa i përket të drejtave për pjesëmarrje në jetën publike, siç është shtjelluar në Konventën Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare¹³ e ne veçanti në Komentarin Tematik të Komisionit Këshillëdhënës për pjesëmarrje efektive të personave që i përkasin pakicave nacionale në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike dhe çështje publike,¹⁴ dhe për mos-diskriminimin dhe qasjen e barabartë në shërbim publik në kuadër të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike¹⁵. Të dy instrumentet ndërkombëtare për të drejtat e njeriut janë drejtpërsëdrejti të zbatueshme në Kosovë.¹⁶

3. PËRBËRJA

Sipas kritereve të specifikuara në Ligj, duhet të jenë 23 anëtarë që i përfaqësojnë komunitetet në pakicë numerike,¹⁷ si dhe përfaqësues nga institucione të caktuara të nivelit qendror (më shumë hollësi për këto institucione janë dhënë në pjesën 4.2 më poshtë.) KKK nuk ka përfaqësues të komunitetit shqiptar të Kosovës. Përbërja e KKK—është në pajtim me këto kritere në të dy mandatet që janë duke u vlerësuar.¹⁸ Në të dy mandatet, të gjithë përfaqësuesit e komuniteteve janë nominuar nga asociacionet e akredituara përfaqësuese të komuniteteve përkatëse,¹⁹ përveç përfaqësuesve të komunitetit ashkali të Kosovës pasi që nuk kishte organizata të akredituara që e përfaqësonin këtë komunitet në asnjërin mandat.²⁰

Për sa i përket barazisë gjinore, përfaqësimi i grave në KKK është shumë nën kriteret e parapara në statutin e KKK—së për përbërjet e të dy mandateve që janë duke u vlerësuar. Statuti e specifikon që komunitetet të cilat i kanë nga dy ulëse në KKK, përfaqësimi gjinor duhet të jetë i balancuar dhe për komunitetet të cilat i kanë tre apo pesë ulëse, asnjëra gjini nuk duhet të këtë përfaqësim më të ulët se 40 për qind.²¹ Derisa baraspeshimi gjinor është përmirësuar pak në mandatin 2016–2018, komunitet egjiptian, goran, dhe rom të Kosovës janë përfaqësuar tërësisht nga burrat në të dy mandatet e KKK—së. Përfaqësimi i grave ka qenë joadekuat edhe në radhët e komunitetit serb të Kosovës si dhe për komunitetin kroat të Kosovës (vetëm për mandatin 2014–2016). Gratë në përgjithësi kanë përfaqësuar vetëm 17 përqind të ulëseve në mandatin 2014–2016, dhe 26 përqind në mandatin 2016–2018. Shifra 1 më poshtë për ndarje gjinore të anëtarëve të KKK—së nga secili komunitet.

¹³ *Konventa Kornizë e Këshillit të Evropës, për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare*, Shkurt 1995, Neni 15. <https://rm.coe.int/CoERMPublicCommonSearchServices/DisplayDCTMContent?documentId=09000016800c10cf>, (e qasur më 13 mars 2017).

¹⁴ Komisioni Këshillëdhënës i Konventës Kornizë për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare, Komentarin për pjesëmarrje efektive të personave që i përkasin pakicave nacionale në jetën kulturore, sociale dhe ekonomike dhe çështje publike, 27 shkurt 2008, ACFC/31DOC(2008)001, para. 107, 109, 110 and 117.

¹⁵ *Pakti Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike* i Organizatës së Kombeve të Bashkuara, 23 mars 1976, neni 2 dhe 25. <http://www.ohchr.org/EN/ProfessionalInterest/Pages/CCPR.aspx>, (i qasur më 13 mars 2017).

¹⁶ Shih Kushtetutën, 15 qershor 2008, nenet 22, 58.2 dhe 123. Konventa Ndërkombëtare për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor dhe Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut janë gjithashtu të aplikueshme. Nenet 5(c) dhe 21(2) respektivisht, janë relevante për këtë çështje.

¹⁷ Ligji për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave dhe interesave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre është ndryshuar e plotësuar më 8 dhjetor 2011 për t'i përfshirë dy komunitete shtesë që nuk ishin përfshirë në ligjin e mëparshëm, pra komunitetin kroat dhe malazet të Kosovës. Në nenin 12.6 të Ligjit për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, shënimi 10 më lartë. 'Dy përfaqësues të komunitetit rom, egjiptian, goran, ashkali malazet dhe tre përfaqësues të komunitetit boshnjak dhe turk, si dhe pesë përfaqësues të komunitetit serb. I qasur në :

<http://www.kuvendikosoves.org/common/docs/ligjet/Laë%20on%20amending%20the%20laë%20on%20communities.pdf>.


¹⁸ Në mandatin 2014–2016 në anëtar i komunitetit rom dhe një anëtar i komunitetit ashkali kanë dhënë dorëheqje mirëpo sipas informatave të pranuar nga sekretariati, këta anëtarë janë zëvendësuar në pajtim me procedurat relevante.

¹⁹ Siç është cekur në nenin 12.7 të Ligjit për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, shënimi 10 sipër.

²⁰ Në këtë rast, përfaqësuesit kanë qenë kandidatë të pavarur të cilët janë emëruar drejtpërdrejt nga Zyra e Presidentit, siç është cekur në nenin 12.7 të Ligjit për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, shënimi 10 sipër.


²¹ Neni 6.4.1 i Statutit, shënimi 11 sipër.

Figura 1. Zbërthimi gjinor i anëtarëve të KKK–së nga secili komunitet



Përveç Sekretariatit të KKK–së që si organ koordinues përgjegjës për të siguruar funksionalitetin dhe organizimin e punës së përditshme të KKK–së, përbëhet vetëm nga katër persona përfshirë këtu edhe sekretarin e përgjithshëm, dy zyrtarë ligjor dhe një zyrtar për komunikim.²² I gjithë personeli i Sekretariatit janë shërbyes civilë që paguhen nga linja buxhetore e Zyrës së Presidentit. Sipas intervistave të bëra me personelin, Sekretariati i KKK–së do të përfitonte në masë të madhe nga angazhimi i një punonjësi shtesë për kryerje më të mirë të detyrave të tij.

4. VEPRIMTARIA DHE NDIKIMI I PUNËS SË KKK–SË



4.1 Komunikimi me komunitete

Njëri prej roleve kryesore të KKK–së është të ofrojë kanal komunikimi mes komuniteteve dhe qeverisë.²³ Më shumë detaje janë dhënë edhe në Ligjin për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Kosovë (neni 12), ku thuhet që mandati i KKK–së është të “ofrojë forum për bashkërendim dhe konsultim mes komuniteteve” (12.1b), si dhe që të “ngrejë vetëdijen për brengat e komunitetit” (12.1i). Është pra me rëndësi që të vlerësohet jo vetëm marrëdhënia ndërmjet KKK–së dhe institucioneve relevante qeveritare, por edhe marrëdhënia ndërmjet KKK–së dhe komuniteteve që ai përfaqëson, ashtu që të përfaqësojë efektivisht qëndrimet e këtyre komuniteteve. Në këtë drejtim, aktivitetet e komunikimit janë element i rëndësishëm i punës së KKK–së.²⁴

²² Sekretarja e përgjithshme është grua – derisa dy zyrtarët ligjor dhe zyrtari i komunikimit janë burra.


²³ Kjo gjë është përcaktuar shprehimisht në Kushtetutë (neni 60.3.1).

²⁴ Neni 13.2.3 i Statutit të KKK–së thekson që Sekretariati i KKK–së duhet të mbështesë aktivitetet e kontaktimit dhe të promovojë dukshmërinë e KKK–së, shih fusnotën 11 *supra*.

Për të vlerësuar lidhjet ndërmjet KKK–së dhe komuniteteve, ekipet e terrenit të OSBE–së kanë intervistuar 97 përfaqësues jo–shqiptarë të komiteteve të komuniteteve (KK)²⁵ në 34 komuna në Kosovë.²⁶ Anëtarët e KK–së janë zgjedhur duke marrë parasysh që këto organe janë të themeluara në secilën komunë në Kosovë, si dhe përveç kësaj, pasi që si anëtarë të KK–së, këta përfaqësues janë propozuar si kandidatë nga pjesëtarët e komuniteteve në pakicë numerike në komunë.²⁷ Si të tillë, respondentët duhet të kenë vështrim më të mirë të çështjeve me të cilat përballen komunitetet në komunë, si dhe të kenë raporte të forta me pjesëtarët e komuniteteve.

4.1.1 Nivelet e vetëdijes së KKK–së dhe anëtarëve të tij

Të dhënat e mbledhura zbulojnë që në përgjithësi, ka vetëdije tejet të ulët për KKK–në për nivelin komunal. Diagrami i mëposhtëm (Figura 2) tregon që nga 97 përfaqësues të Komiteteve të Komunitetit që janë intervistuar, vetëm një e treta (33) theksojnë që janë të vetëdijshëm për këtë mekanizëm. Nga ky numër, vetëm 21 (që barazohet me 22 për qind në total) kanë treguar me saktësi që KKK–ja është organ konsultativ brenda Zyrës së Presidentit. Kjo lë dy të tretat e atyre të intervistuarve pa asnjë vetëdije për mekanizmin apo rolin e tij.



Përfaqësuesit e komiteteve të komuniteteve

Kur bëhet pyetja nëse përfaqësuesit e Komiteteve janë të vetëdijshëm për anëtarin që përfaqëson komunitetin e tyre në KKK, nivelet e vetëdijes janë të ulëta. Vetëm 12 përfaqësues të Komiteteve kanë raportuar të njohin përfaqësuesin e tyre për mandatin 2014–2016, si dhe 14 për mandatin 2016–2018. Nivelet e raportuara të kontaktit me mekanizmin në përgjithësi apo me përfaqësues individualë të KKK–së qenë specifikisht edhe më të ulëta, ku vetëm dhjetë respondentë raportojnë të kenë pasur ndonjë kontakt me KKK–në gjatë periudhës së raportimit, derisa vetëm

²⁵ Përfshin 13 ashkali (një grua, 12 burra), 12 boshnjakë (nëntë gra, tre burra), dy kroatë (një grua, një burrë), gjashtë egjiptas (një grua, pesë burra), tre goranë (tri gra), një malazeze (grua), 24 romë (të gjithë burra), 26 serbë (shtatë gra, 19 burra), si dhe 10 turq të Kosovës (një grua, nëntë burra) (gjithsej 24 gra dhe 73 burra).

²⁶ Pasi që nuk ka përfaqësues jo-shqiptarë të komiteteve të komuniteteve në Glogocv, Hani i Elezit, Junik, apo Kaçanik, këto komuna nuk janë përfshirë në grumbullimin e të dhënave.

²⁷ Udhëzimi i Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nr. 03/2014, për Procedurën e themelimit, përbërjen dhe kompetencat e Komiteteve të Përhershme në Komunë, neni 10.

njëri raporton të jetë konsultuar nga KKK—ja në lidhje me qëndrimet e tyre për ndonjë akt ligjor, politikat publike dhe programet me rëndësi për komunitete.²⁸ Përveç këtyre, vetëm dy respondentë raportojnë të jenë të vetëdijshëm për aktivitetet e kontaktimit që janë ndërmarrë nga KKK—ja gjatë periudhës së raportimit. Sipas informatave të ofruara nga Sekretariati i KKK—së, vizitat kontaktuese dhe tryezat e rrumbullakëta janë mbajtur nga KKK—ja gjatë periudhës së raportimit,²⁹ por ka pasur mungesë të përpjekjeve të vazhdueshme për të konsultuar komunitetet ashtu që të formulohen qëndrimet e konsoliduara të anëtarëve të tyre në lidhje me legjislacionin, politikat publike dhe programet me rëndësi për komunitetet.³⁰ Andaj KKK duhet të jetë më proaktiv në kërkimin e komenteve nga përfaqësuesit e komuniteteve përkitazi me legjislacionin, politikat publike dhe programet e rëndësishme për komunitetet.

Organizatave përfaqësuese të komuniteteve (OPK—të)

Përveç mbledhjes së të dhënave nga përfaqësuesit e KK—ve, mbledhja e të dhënave për këtë vlerësim ka përfshirë edhe përfaqësuesit e shoqatave joqeveritare që përfaqësojnë komunitetet dhe organizatat që janë akredituar nga Zyra e Presidentit. Nivelet e vetëdijes së përfaqësuesve të komuniteteve individuale në KKK ishin shumë më të larta për këtë grup të respondentëve ku të gjithë përveç një përfaqësuesi të intervistuar të OPK—ve raportojnë që e kanë njohur anëtarin e tyre në KKK që përfaqëson komunitetin e tyre për të dyja mandatet që kanë qenë funksionale në periudhën e raportimit. Nivelet e kontaktit me KKK—në në si në përgjithësi ashtu edhe me përfaqësuesit individualë të komuniteteve ishin ngjashëm të larta, ku të gjithë pos njërit prapë raportojnë një nivel të caktuar kontakti në periudhën e raportimit. Në lidhje me njohurinë për iniciativat e kontaktimit, megjithatë, përgjigjet pozitive nga ky grup ishin gjithashtu në numër të vogël, ku vetëm një nga nëntë përfaqësues raporton të ketë njohuri për aktivitetet e tilla nga KKK—ja.³¹ Përveç këtyre, asnjë nga përfaqësuesit e OPK—ve nuk raporton të jetë konsultuar nga KKK—ja në lidhje me qëndrimet ndaj legjislacionit, politikave publike dhe programeve me rëndësi për komunitetet.

Nivelet tejet të ulëta të vetëdijes për KKK—në në përgjithësi kanë ndikim të gjerë në funksionimin dhe efektshmërinë e mekanizmit. Pasi që anëtarët e KKK—së që përfaqësojnë komunitetet duhet të vijnë nga organizatat e akredituara të komuniteteve,³² rrjedh që njohuritë e pakta për mekanizmin çojnë drejt numrit të vogël të organizatave që kërkojnë akreditimin dhe që akreditohen.³³ Në fakt, sipas informatave të dorëzuara nga Sekretariati i KKK—së, numri i organizatave të akredituara për mandatin e periudhës 2014–2016 ka qenë 36, derisa për mandatin 2016–2018, 53. Shih figurën 3 më poshtë për numrin e OPK—ve të akredituara për secilin komunitet.

²⁸ Siç përcaktohet tek neni 12.1a të igjtit për Mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, *supra* fusnota 10.

²⁹ Sipas raporteve vjetore të KKK—së nga vitet 2015 dhe 2016, KKK—ja ka organizuar vizita kontaktuese me përfaqësues të komuniteteve dhe organizata të akredituara nga komunitetet individuale në nëntor dhe dhjetor 2015, si dhe shkurt e mars 2016, por edhe një tryezë të rrumbullakët me përfaqësues të Organizatave Përfaqësuese të Komuniteteve.


³⁰ Intervista me një përfaqësues nga Sekretariati i KKK—së, mbajtur më 3 maj 2017. Sipas respondentit, KKK—ja nuk ka bërë përpjekje për të konsultuar komunitetet në lidhje me qëndrimet e tyre për legjislacionin, pasi që qëndrimi i respondentit ishte që komunitetet kryesisht brengosen për çështjet e përditshme, e jo legjislacionin, si dhe përveç kësaj, për shkak se përfaqësuesit e KKK—së vijnë nga fusha, kështu që do të duhej të ishin në gjendje të reflektonin në mënyrë adekuate qëndrimet e komuniteteve në lidhje me komentet apo rekomandimet në lidhje me legjislacionin.

³¹ Një përfaqësues i serbëve të Kosovës kujtonte një takim të KKK—së me pjesëtarët e komunitetit serb të Kosovës të organizuar në Ulpianë në Prishtinë më 2016.

³² Neni 5.3 i Statutit të Këshillit Konsultativ për Komunitete, shih fusnotën *supra* 11.

³³ Procedurat për procesin e akreditimit përcaktohen me Statutin e KKK—së, fusnota *supra* 11.

Figura 3. Numri i organizatave përfaqësuese të komuniteteve të akredituara për secilin komunitet



Kështu, sa më i vogël spektri i anëtarëve të mundshëm të KKK-së, aq më i kufizuar bëhet mekanizmi, edhe në kuptimin e anëtarëve që saktësisht përfaqësojnë qëndrimet e komuniteteve që ata priten të përfaqësojnë në KKK, por edhe në kuptimin e aftësive dhe përvojës që janë të domosdoshme për të realizuar në mënyrë kompetente detyrat dhe përgjegjësitë e të qenit anëtar i KKK-së. Përveç këtyre, përfaqësimi minimal i grave nga komunitetet e ndryshme ndikon edhe në përfshirjen e perspektivës femërore si dhe identifikimin e nevojave që në fillim, pra ekziston brenga nëse anëtarët janë në gjendje të përfaqësojnë në mënyrë adekuate nevojat përkatëse të grave nga komunitetet e ndryshme.

4.1.2 Vlerësimi i punës së KKK-së

Qëndrimet e anëtarëve të Komiteteve dhe përfaqësuesve të OPK-ve në lidhje me punën e KKK-së, e sidomos nëse KKK-ja mjaftueshëm ka përfaqësuar çështjet me interes për komunitetet në institucionet e Kosovës kanë qenë kryesisht negative. Nga numri relativisht i vogël i anëtarëve të KK-ve që kanë pasur njohuri për KKK-në, pesë (që përfaqësojnë 15 për qind të atyre që dinë për KKK-në) theksojnë që KKK-ja punon mjaftueshëm për të përfaqësuar çështjet e komuniteteve. Një përqindje e konsiderueshme (39 për qind të atyre që kanë njohuri për KKK-në) kanë theksuar që KKK nuk ka punuar mjaftueshëm për të përfaqësuar çështjet e komuniteteve, derisa anëtarët tjerë të KK-ve (46 për qind të atyre që janë të vetëdijshëm për KKK-në), në anën tjetër, vlerësojnë që KKK-ja nuk ka punuar fare për të ngritur çështjet relevante. Shumica e anëtarëve të KK-ve që kanë dhënë detaje të mëtutjeshme mbi arsyet për vlerësimin e tyre negativ për KKK-në (nëntë) theksojnë që KKK-ja duhet të bëjë më shumë për të rritur dukshmërinë dhe vetëdijen për mekanizmin dhe të ndajë informata për punën e tij, duke treguar kështu që ky perceptim rrjedh më shumë nga mungesa e informatave sesa ndonjë vlerësim negativ i vetë punës. Të gjitha, pos njëres, OPK-të ngjashëm konsiderojnë që puna e KKK-së në lidhje me ngritjen e çështjeve me interes për komuniteteve para institucioneve të Kosovës nuk ka qenë e mjaftueshme.³⁴ Mes arsyeve që jepen për këtë vlerësim negativ janë edhe mungesa e kompetencave ekzekutive të mekanizmit dhe mungesa e aktivitetit të anëtarëve të KKK-së.

³⁴ Përfaqësuesi i OPK-së nga komuniteti turk i Kosovës ka dhënë përgjigje pozitive, por pa ndonjë detaj të mëtutjeshëm.


4.2 KKK si lidhje mes komuniteteve dhe institucioneve të Kosovës

4.2.1 Institucionet me anëtarësi të përhershme në KKK

Përveç përfaqësuesve të komuniteteve, përbërja e KKK-së gjithashtu përfshin përfaqësues nga institucionet që janë anëtare të përhershme të KKK-së. Këto institucione janë

- Zyra e Presidentit,
- Zyra e Kryeministrit,
- Zyra e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, si dhe
- Ministria e Komuniteteve dhe Kthimit.

Këto institucione duhet të emërojnë përfaqësues të lartë të përhershëm dhe duhet të sigurojnë që të gjitha mbledhjet të ndiqen.³⁵ Sipas informatave të marra nga Sekretariati i KKK-së, të gjitha këto institucione kanë emëruar përfaqësues të lartë për pjesëmarrje në mbledhjet e KKK-së, përveç Zyrës së Kuvendit të Kosovës në mandatin 2016–2018.³⁶ Përveç këtyre, Zyra e Kryeministrit ka emëruar udhëheqësin e Zyrës për Çështjeve të Komuniteteve (ZÇK) si përfaqësues të saj në KKK, gjë që është cituar të jetë problematike nga Sekretariati i KKK-së.³⁷ Diagrami i mëposhtëm (Figura 2) paraqet vlerësimet e përfaqësuesve të komuniteteve në KKK në lidhje me raportet ndërmjet KKK-së dhe institucioneve që kanë anëtarësi të përhershme në KKK.



Sipas përfaqësuesve të komuniteteve në KKK, si në mandatin 2014–2016 ashtu edhe në atë 2016–2018,³⁸ nga ato institucione që kanë anëtarësi të përhershme në KKK, marrëdhënia më pozitive është ajo me Zyrën e Presidentit. Në fakt, të gjithë anëtarët që janë intervistuar e kanë vlerësuar këtë marrëdhënie pozitivisht (në kuptimin e ndarjes së informatave, përgjigjeve ndaj kërkesave për informata, përgjigjeve ndaj rekomandimeve të KKK-së, etj.) Vlerësimet e marrëdhënies së KKK-së me Zyrën e Kryeministrit dhe Ministrinë e Komuniteteve dhe Kthimit nuk ishin kaq pozitive. Në fakt, më se gjysma e anëtarëve të KKK-së të intervistuar e shohin marrëdhënien mes këtyre institucioneve dhe KKK-së ose si të “keqe” ose “tejet të keqe”. Sa i

³⁵ Sipas nenit 4.3 dhe 4.4 të Statutit të KKK-së, fusnota *supra* 11.

³⁶ Sipas Sekretariatit të KKK-së, është dërguar ftesa për Zyrën e Kryetarit të Kuvendit të Kosovës, por nuk ka marrë përgjigje (intervistë me përfaqësuesin e Sekretariatit të KKK-së, 3 maj 2017).

³⁷ Ky emërim është parë të jetë problematik nga Sekretariati i KKK-së, pasi që ka konflikte të mundshme interesi ndërmjet KKK-së dhe ZÇK-së (pasi që ZÇK-ja ka buxhet substancial për ndarjen e granteve për organizata joqeveritare në të cilat mund të aplikojnë anëtarët e KKK-së nga organizatat e akredituara), si dhe me këtë emërim, ZÇK-ja është i vetmi kontakt për KKK-në me Zyrën e Kryeministrit. Sipas informatave nga Sekretariati i KKK-së, udhëheqësi i ZÇK-së nuk i ndjek rregullisht mbledhjet. Për sa i përket kompetencave, ZÇK gjithashtu konsiderohet si mekanizëm në kuadër të Zyrës së Kryeministrit që ka kompetenca ekzekutive, derisa KKK është organ konsultativ.

³⁸ Të dhënat nuk janë të disponueshme për anëtarët malazezë në përbërjen 2014-2016, si dhe anëtarin kroat në përbërjen 2016–2018.

përket marrëdhënies mes KKK-së dhe ZKM-së, arsyeja më së shpeshti e përmendur që respondentët e japin për pakënaqësinë e tyre ishte që përfaqësuesi i emëruar i ZKM-së nuk ndiqte mbledhjet e KKK-së.³⁹ Anëtarët e KKK-së që e vlerësojnë negativisht marrëdhënien ndërmjet KKK-së dhe MKK-së ngrënë çështjen e përfaqësuesit të MKK-së që nuk merr pjesë në mbledhje.⁴⁰

4.2.2 Si reagojnë institucionet ndaj rekomandimeve të KKK-së

Për të vlerësuar më tutje funksionimin e KKK-së si lidhje mes komuniteteve dhe institucioneve të Kosovës, grumbullimi i të dhënave për këtë raport ka përfshirë edhe informata për rekomandimet që KKK-ja i ka dhënë institucioneve të ndryshme, si dhe ka përcjellë përgjigjet apo edhe rezultatet.⁴¹ Sipas Statutit të KKK-së, çdo institucion që pranon rekomandimin e KKK-së është i obliguar t'i përgjigjet KKK-së për veprimet e planifikuara dhe të realizuara si reagim ndaj rekomandimit, apo arsyet për mosveprim, brenda një muaji nga pranimi i rekomandimit.⁴² Gjatë periudhës së raportimit, KKK-ja ka dorëzuar gjashtë rekomandime për 18 institucione të veçanta të nivelit qendror dhe komunal. (shih Shtojcën 1 për detajet e secilit rekomandim) Këto rekomandime kanë trajtuar çështje që kanë të bëjnë me:

- Lëshimin e dokumenteve të gjendjes civile;
- Punësimin e komuniteteve në pakicë numerike në shërbimin civil;
- Të drejtat gjuhësore, qasjen e barabartë dhe përfaqësimin e Radio Televizionit të Kosovës;
- Si dhe qasjen në arsim.

Nga këto gjashtë rekomandime, KKK-ja ka marrë vetëm përgjigje nga dy institucione⁴³ në lidhje me njërin rekomandim. Përveç kësaj zhvillime pozitive janë vërejtur në lidhje me katër nga rekomandimet. Derisa është pozitive që janë parë përmirësime në lidhje me shumicën e brengave të ngritura nga KKK-ja, fakti që përgjigja direkte ndaj rekomandimit është marrë vetëm në lidhje me njërin prej rekomandimeve⁴⁴ do të thotë që nuk është e mundur për KKK-në të dijë nëse janë bërë përmirësime si pasojë e këtij rekomandimi apo jo. Për më tepër, mungesa e përgjigjeve ndaj rekomandimeve të KKK-së tregon që ka hapësirë për përmirësim në lidhje me komunikimin ndërmjet KKK-së dhe institucioneve.

Për të vlerësuar marrëdhënien ndërmjet KKK-së dhe institucioneve të cilave iu janë dërguar rekomandimet, mbledhja e të dhënave për këtë vlerësim ka përfshirë edhe kontaktimin e personit relevant të secilit institucion. Nga 18 institucione të cilave i ka dërguar KKK-ja rekomandime, OSBE-ja nuk ka arritur të marrë informata nga gjashtë,⁴⁵ derisa për 12 institucionet tjera,⁴⁶ përgjigjet kanë qenë të përziera. Përfaqësuesit e pesë institucioneve që janë kontaktuar kanë

³⁹ Cituar nga përfaqësuesi ashkali, rom dhe serb nga përbërja 2014-2016, si dhe përfaqësuesi i MKK-së, ai rom dhe ai serb në përbërjen e viteve 2016-2018.

⁴⁰ Cituar nga përfaqësuesi i Sekretariatit të KKK-së, përfaqësuesi ashkali, boshnjak, egjiptas, si dhe ai rom në përbërjen e viteve 2014-2016, si dhe përfaqësuesi ashkali nga përbërja e viteve 2016-2018.

⁴¹ Ky aspekt i mandatit të KKK-së është shprehimisht i trajtuar në Ligjin për mbrojtjen e të drejtave të komuniteteve, neni 12.12, fusnota *supra* 10.

⁴² Neni 24.2 i Statutit të KKK-së, fusnota *supra* 11.

⁴³ KKK e ka shqyrtuar përgjigjen nga Radio Televizioni i Kosovës dhe Agjencia e Regjistrimit Civil.

⁴⁴ Rekomandimet e dorëzuara në Agjencinë e Regjistrimit Civil janë marr para sysh nga ky institucion dhe zbrazëtirat e konstatuara në dokumente në lidhje me dokumentet civile janë rregulluar.


⁴⁵ OSBE-ja nuk ka arritur të marrë informata nga institucionet vijuese: Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (dy rekomandime për MASHT-in), si dhe komuna e Mitrovicës së Jugut.

⁴⁶ Përgjigjet janë pranuar nga: Agjencia e Regjistrimit Civil, Ministria e Integritimit Evropian, Zhvillimit Ekonomik, Shëndetësisë, si dhe Tregtisë e Industrisë, komunat Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjiilan dhe Vushtrri, Radio Televizioni i Kosovës si dhe Universiteti i Prishtinës.

theksuar që nuk kanë pasur njohuri që institucioni ka pranuar rekomandim nga KKK-ja.⁴⁷ Për ato gjashhtë institucione që kanë njohuri për pranimin e rekomandimit, të gjitha kanë raportuar që janë ndërmarrë veprime pozitive për të adresuar brengat e KKK-së.⁴⁸

4.3 Komentimi për iniciativat legjislative dhe të politikave

Përveç ofrimit të mekanizmit për këmbim të rregullt ndërmjet komuniteteve dhe qeverisë, roli tjetër parësor i KKK-së është që t'i jep komuniteteve mundësinë për komentim në një fazë të hershme të iniciativave legjislative dhe të politikave që mund të përgatiten nga qeveria.⁴⁹ Në fillim të secilit vit kalendarik, kur të pranohet agjenda legjislative nga KKK, ajo shpërndahe tek të gjithë anëtarët e KKK-së, nga të cilët kërkohet që të tregojnë se cilat projektligje apo strategji të planifikuara dëshirojnë t'i rishikojnë. Porsa projektligji të pranohet nga KKK, komentet mund të dorëzohen brenda 15 ditëve,⁵⁰ dhe nga institucioni relevant duhet të pranohet një përgjigje e arsyetuar brenda një muaji.⁵¹ Për të ndihmuar në këtë aspekt të punës së KKK-së, Sekretariati i KKK-së duhet të ofroj këshilla juridike, siç është përvijuar në Statutin e KKK-së.⁵² Sipas kryesuesit të grupit punues për legjislacion, nuk ka ndonjë problem nëse KKK i pranon projektligjet dhe strategjitë për rishikim me kohë.⁵³ Figura 3 më poshtë i përmend shifrat e ligjeve dhe strategjive që i ka pranuar KKK (nga ato që ka planifikuar t'i shqyrtoj),⁵⁴ i ka shqyrtuar dhe komentuar në vitin 2015 dhe 2016.



⁴⁷ Institucionet vijuese kanë raportuar të mos kenë pranuar rekomandim nga KKK-ja: Ministria e Integritimit Evropian, Ministria e Shëndetësisë, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, si dhe komunat Gjilan e Vushtrri, si dhe Universiteti i Prishtinës.

⁴⁸ Institucionet vijuese kanë raportuar të kenë ndërmarrë veprime në përgjigje ndaj rekomandimit të KKK-së: Agjencia e Regjistrimit Civil, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, komunat Prishtinë, Prizren dhe Pejë, si dhe Radio Televizioni i Kosovës.

⁴⁹ Shih Kushtetutën, neni 60.3.2, *shënimi sipër 9*.

⁵⁰ Sipas Rregullores nr.09/11 për punën e qeverisë, 12 shtator 2011, [http://ëë.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullore_e_punes_se_Qeverise_09.2011_\(anglisht\).pdf](http://ëë.kryeministri-ks.net/repository/docs/Rregullore_e_punes_se_Qeverise_09.2011_(anglisht).pdf)

⁵¹ Sipas neni 12.12 të Ligjit nr. 03/L-047 për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtërëve të tyre në Kosovë, *shënimi sipër 10*.

⁵² Neni 13.2.6 i Statutit të KKK-së, *shënimi sipër 11*.

⁵³ Intervista me Zijush Ahmetin, Zyrtar i lartë ligjor, Sekretariati i KKK-së, 2 qershor 2017.

⁵⁴ Shpesh ka mospërputhje ndërmjet agjendës legjislative dhe asaj që është shpërndarë për rishikim, për shkak të vonesave në hartim. Për shembull, në vitin 2015 KKK kishte planifikuar që t'i rishikoj 18 ligje mirëpo vetëm nëntë nga to ishin shpërndarë për rishikim, dhe në vitin 2016 numri ishte 30, në krahasim me shtatë të shpërndara.

Diagrami tregon që KKK i ka shqyrtuar pothuajse të gjitha projektligjet dhe strategjitë që i ka pranuar gjatë periudhës raportuese. Për periudhën e vitit 2015, vetëm një ligj dhe një strategji nuk janë shqyrtuar nga KKK.⁵⁵ Për vitin 2016, vetëm një ligj është që është pranuar nuk është shqyrtuar.⁵⁶ Sipas informacioneve të marra nga Sekretariati i KKK-së, arsyeja kryesore për mos-shqyrtimin e këtyre ligjeve dhe strategjive ishte se KKK nuk ishte në gjendje t'i rishikonte ato brenda afatit shumë të shkurtë të kërkuar (15 ditë) për projektligjet dhe strategjitë e shqyrtuara, megjithatë, KKK ka paraqitur komente vetëm në dy dokumente gjatë periudhës raportuese dyvjeçare. Në vitin 2015, KKK-ja dorëzoi amendamentet e propozuara mbi projektligjin për banimin social që përfshinte dispozita për komunitetet në pakicë numerike dhe personat e zhvendosur. Këto komente nuk janë inkorporuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor dhe KKK nuk ka marrë fare informacion nga Ministria lidhur me arsyet se pse nuk janë inkorporuar komentet. Në vitin 2016 KKK-ja në mënyrë të ngjashme paraqiti amendamentet e propozuara për projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr. 2004/37 për Inspeksionin e Arsimit në Kosovë që përfshinin garanci për përfaqësimin e komuniteteve në pakicë numerike dhe mori përgjigje nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë që përfshirja e propozuar tashmë ishte e mbuluar me ligjin për shërbimin civil. Përderisa nuk ka dispozita ligjore që përcaktojnë se sa ligje dhe strategji duhet të vlerësohen dhe komentohen nga KKK, komentimi i vetëm dy ligjeve në periudhën dyvjeçare të mbuluar nga raporti, pa inkorporim të suksesshëm të komenteve në asnjë ligj, sugjeron që ndikimi i KKK në këtë rol parësor ka qenë shumë i kufizuar gjatë periudhës së raportimit.

4.4 Pengesat në përmirësimin e funksionimit, fuqisë dhe ndikimit të KKK

4.4.1 Mendimet e përfaqësuesve të komuniteteve në KKK

Vlerësimet e anëtarëve të KKK-së⁵⁷ për punën e KKK-së janë kryesisht pozitive. Shtatëmbëdhjetë nga 18 anëtarët e intervistuar vlerësuan se komunikimet ndërmjet KKK-së dhe komuniteteve gjatë periudhës së raportimit ishin ose 'shumë të mira' ose 'të mira'.⁵⁸ Ngjashëm, 11 nga 18 anëtarë të KKK-së vlerësuan se konsultimet ndërmjet anëtarëve të KKK-së dhe komuniteteve ishin të mjaftueshme në periudhën e raportimit.⁵⁹ Për sa i përket aktiviteteve të vetëdijesimit dhe kontaktit në terren, të kryera nga KKK gjatë kësaj kohe, dhjetë nga anëtarët e intervistuar i vlerësuan këto përpjekje si adekuate dhe tetë i konsideruan si joadekuate. Shumica dërrmuese e anëtarëve të intervistuar të KKK-së u përgjigjën se sipas mendimit të tyre, KKK përfaqësonte mjaftueshëm çështjet me të cilat përballen komunitetet në institucionet e Kosovës.⁶⁰ Këto vlerësime pozitive dallojnë ndjeshëm nga ato që janë dhënë nga anëtarët e KKK-ve në komuna dhe përfaqësuesit e shoqatave dhe organizatave joqeveritare përfaqësuese të komuniteteve. Figura 4 më poshtë përshkruan pengesat e cekura nga anëtarët e KKK-së për përmirësimin e funksionimit, si dhe rritjen e fuqisë dhe ndikimit të KKK-së.

⁵⁵ Projektligji për Kartela të Identitetit Elektronike dhe projekt-strategjia për vetëqeverisje lokale 2016–2026.

⁵⁶ Projektligji për Akademinë e Drejtësisë.


⁵⁷ Nuk ka të dhëna për pjesëtarët malazezë të Kosovës për përbërjen në periudhën 2014–2016 dhe pjesëtarët kroatë të Kosovës për 2016–2018.

⁵⁸ Të anketuarit që vlerësuan komunikimin si 'shumë të mirë' shtatë, 'mirë' dhjetë, 'keq' një, 'shumë keq' zero.

⁵⁹ Të anketuarit që vlerësuan konsultimet ndërmjet anëtarëve të KKK dhe komuniteteve si 'mjaftueshme' 11, 'të pamjaftueshme' gjashtë, 'nuk ka pasur fare' një.

⁶⁰ Të anketuarit që vlerësuan përfaqësimin e KKK të çështjeve me të cilat përballen komunitetet në institucionet e Kosovës si të 'mjaftueshme': dymbëdhjetë, 'të pamjaftueshme': katër.

Figura 4. Pikëpamjet e anëtarëve (përfaqësuesve të komunitetit) në lidhje me pengesat për përmirësimin e funksionimit dhe efektivitetit të KKK



Në pyetjen e hapur për pengesat me të cilat përballlet KKK-ja, çështjet më të shpeshta të cekura nga anëtarët e KKK-së ishin se buxheti për KKK ishte i pamjaftueshëm⁶¹ dhe se KKK-ja nuk gëzonte mbështetje të lartë nga institucionet (nëntë nga 18 anëtarë të KKK i kanë theksuar të gjitha këto çështje si pengesa për përmirësimin e funksionimit të KKK). Aktualisht nuk është ndarë ndonjë buxhet për KKK-në për OPK-të. Sekretariati i KKK-së ka dërguar kërkesë në Ministrinë e Financave dhe Zyrën e Kryeministrit, si dhe Komitetin e Kuvendit për Buxhet, ku e ka cekur këtë çështje mirëpo ende nuk ka pranuar përgjigje.⁶²

Statusi i KKK-së si organ konsultativ pa kompetenca ekzekutive është përmendur gjithashtu si pengesë për përmirësimin e funksionimit të mekanizmit. Kur janë pyetur se në çfarë mënyre anëtarët e KKK-së vlerësojnë fuqinë dhe ndikimin e KKK-së në kuptim të sigurimit që çështjet që kanë të bëjnë me komunitetet merren parasysh nga institucionet e Kosovës, shumica e anëtarëve të intervistuar kanë dhënë përgjigje negative; duke theksuar se sipas mendimit të tyre forca dhe ndikimi i KKK-së janë të dobëta ose shumë të dobëta.⁶³ Pengesat më të shpeshta ishin mungesa e mbështetjes nga institucionet e Kosovës (duke përfshirë edhe dështimin e institucioneve për të marrë në konsideratë rekomandimet e KKK), pasuar nga një mungesë e përgjithshme e ndërgjegjësimit të mekanizmit si brenda institucioneve të Kosovës ashtu dhe në komunitetin më të gjerë.

4.4.2 Mendimet e anëtarëve të përhershëm që përfaqësojnë institucionet në KKK

Vlerësimet e punës së KKK-së nga përfaqësuesit e katër institucioneve me anëtarësi të përhershme në KKK ishin më kritike. Kur u pyetën me pyetje të hapura lidhur me pengesat për përmirësimin e funksionimit dhe ndikimit të mekanizmave, gjersa fuqia dhe ndikimi i KKK-së u vlerësua kryesisht si i fortë nga perspektiva e kuadrit ligjor,⁶⁴ përfaqësuesit e këtyre

⁶¹ Sipas buxhetit të Kosovës, buxheti i përgjithshëm për KKK ishte 87,036 euro në vitin 2015 dhe 84,341 euro në 2016, (2015 - <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=10606>, 2016 - <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=11324>, qasur më 20 shtator 2017).

⁶² KKK-ja ka pranuar edhe fonde shtesë nga Ambasada Norvegjeze për projekte që ndërlidhen me komunitetet dhe aktivitetet e kontaktimit në terren që ndërmerren nga anëtarët e saj. Për vitin 2017 është ndarë buxhet për sekretariatit e KKK-së (€43,000) për paga, plus 43,000 për vetë funksionimin e KKK-së, nga të cilat 50 përqind shkon në meditje për anëtarët.

⁶³ Të anketuarit që vlerësuan fuqinë/ndikimin e KKK në kuptim të sigurimit se çështjet preokupuese për komunitetet merren parasysh nga institucionet e Kosovës ishin 'shumë të fortë' asnjë, 'të fortë:' gjashtë, 'të dobët' nëntë, 'shumë të dobët' tre.

⁶⁴ Përfaqësuesi i Zyrës së Presidentit, përfaqësuesi i Zyrës për Çështje Ligjore të Kryeministrit, përfaqësuesi i Zyrës së Kryeministrit, përfaqësuesi i MKK.

institucioneve u përqendruan më shumë te vetë përfaqësuesit e komunitetit. Në mënyrë të veçantë, të intervistuarit theksuan se kapaciteti, angazhimi i anëtarëve nuk ishte i mjaftueshëm realizimin e detyrave të tyre të mandatuara dhe se përkatësitë politike të anëtarëve gjithashtu mund të kenë ndërhyrë në punën e tyre.⁶⁵ Disa nga shqetësimet e njëjta që u ngritën nga përfaqësuesit e komuniteteve janë përmendur edhe nga këta përfaqësues, duke përfshirë mandatin e shkurtër të anëtarëve të KKK-së,⁶⁶ statusin konsultativ të KKK-së⁶⁷ si dhe mungesën e mbështetjes nga institucionet.⁶⁸ Sido që të jetë, shumica e anëtarëve të zgjedhur në KKK kanë pasur nga dy mandate, duke shërbyet në KKK për katër vite.⁶⁹ Vlerësimet në lidhje me përshtatshmërinë e komunikimit në mes të KKK-së dhe komuniteteve dhe konsultimitin e komuniteteve nga anëtarët e KKK-së ishin më pozitive: tre nga katër të anketuar vlerësuan se këto nivele të komunikimit ishin ‘të mira’ ose ‘shumë të mira’.⁷⁰

5. PËRFUNDIME

Për sa i përket lidhjeve ndërmjet KKK-së dhe komuniteteve që i përfaqësojnë anëtarët, gjetjet e këtij hulumtimi janë se nivelet e ndërgjegjësimit në radhët e përfaqësuesve të komuniteteve në nivel komunal janë përgjithësisht të ulëta. Këto nivele të ulëta të ndërgjegjësimit sugjerojnë mungesë të kontaktit adekuat në terren nga ana e KKK dhe të konsultimit të rregullt me komunitetet në lidhje me legjislacionin, politikat publike dhe programet relevante për komunitetet. Konsensusi i përgjithshëm nga intervistat që janë kryer është se buxheti i KKK-së nuk është adekuat për të kryer aktivitete të tilla të kontaktimit në terren ose konsultimeve. Implikimet e kësaj mangësie janë të shumëfishta. Pa konsultime të rregullta, KKK nuk mund të ketë perceptim adekuat të çështjeve me të cilat përballen komunitetet të cilat duhet të adresohen nga ky mekanizëm. Nëse komunitetet nuk janë në dijeni për këtë mekanizëm, atëherë rastet e çështjeve që ngrihen nga anëtarët e komunitetit tek përfaqësuesit e tyre të KKK janë më të rralla, dhe rrjedhimisht më pak çështje ngrihen nga KKK tek institucionet e Kosovës. Mungesa e shkëmbimit kontribuon në uljen e ndikimit të mekanizmit në tërësi. Andaj KKK duhet të bëjë më tepër për të marr komente nga përfaqësuesit e komuniteteve në lidhje me legjislacionin, politikat dhe programet publike të rëndësishme për komunitetet. Në nivel më bazik, mungesa e ndërgjegjësimit për KKK do të thotë se lista e organizatave të akredituara që mund të emërojnë anëtarë të KKK-së nuk është gjithëpërfshirëse. Zgjedhja më e pakët për anëtarë zvogëlon mundësinë që KKK-ja të përbëhet nga përfaqësues të komunitetit të cilët në mënyrë adekuate do të përfaqësonin komunitetin e tyre dhe që kanë kapacitetin për t'i kryer detyrat e kërkuara për të realizuar në tërësi potencialin e këtij mekanizmi. Bilanci i dobët gjinor gjithashtu do të thotë se probabiliteti që çështjet me të cilat përballen gratë të diskutohen dhe adresohen në mënyrë adekuate nga KKK është zvogëluar.

Për sa i përket vlerësimit të lidhjes ndërmjet KKK-së dhe institucioneve të Kosovës, çështjet që kanë të bëjnë me emërimin dhe pjesëmarrjen e anëtarëve që përfaqësojnë institucione që kanë anëtarësi të përhershme në KKK dobësojnë ndikimin e KKK-së në këto institucione. Për më tepër, shkalla relativisht e ulët e reagimit nga institucionet që kanë pranuar rekomandime nga KKK tregon që ka nevojë për përmirësim të bashkëpunimit midis KKK-së dhe institucioneve.

Për sa i përket rolit të KKK-së në ofrimin e komenteve në fazë të hershme të projektligjeve, është konstatim pozitiv i këtij raporti që KKK ka shqyrtuar shumicën e projektligjeve dhe strategjive që

⁶⁵ Përfaqësuesi i Zyrës së Presidentit, përfaqësuesi i Zyrës për Çështje Ligjore të Kryeministrit.

⁶⁶ Përfaqësuesi i KDIIK.

⁶⁷ Përfaqësuesi i MKK.

⁶⁸ Përfaqësuesi i MKK, Përfaqësuesi i Zyrës së Kryeministrit, përfaqësuesi i Zyrës Ligjore të Kryeministrit.

⁶⁹ Intervista me përfaqësuesit e Sekretariatit të KKK-së.

⁷⁰ ‘Shumë mirë’ përfaqësuesi i Zyrës së Presidentit, Përfaqësuesi i Zyrës së Kryeministrit, mirë: përfaqësuesi i MKK.

kishte planifikuar t'i shqyrtojë, mirëpo numri shumë i ulët i komenteve të paraqitura tregon se ndikimi i KKK-së në këtë drejtim është i kufizuar. Në frymë të këtyre konkluzioneve, duket që kapacitetet e KKK-ve duhet të forcohen. OSBE-ja mbetet e përkushtuar në ofrimin e mbështetjes për KKK-në në adresimin e sfidave me të cilat ballafaqohet si dhe rritjen e kapaciteteve të anëtarëve të saj në lidhje me çështjet specifike të cekura në raport.

6. REKOMANDIME

Për Zyrën e Presidentit

- Të sigurohet që buxheti vjetor i KKK–së të jetë i mjaftueshëm për të siguruar funksionim efektiv të tij për të gjitha pikat e listuara në nenin 26.3 të Statutit të KKK–së (jo vetëm kostot minimale që kanë të bëjnë me funksionimin e Sekretariatit dhe takimet).

Për institucionet që pranojnë rekomandime ose komente për projekt–legjislacion nga KKK

- Të sigurohet që KKK–ja të pranoj përgjigje të arsyetuar brenda një muaji, duke përfshirë veprimet e planifikuara dhe të ndërmarra në përgjigje të rekomandimit, ose arsytet për mosmarrjen e masave, siç përcaktohet në nenin 24 të Statutit të KKK–së, neni 12(12) Ligji për komunitete, dhe nenit 70 të Rregullores së punës së qeverisë.

Për Sekretariatit e KKK–së

- Të sigurohet ndërlidhja me institucionet specifike të cilave u janë dërguar rekomandime ose komente për projekt–legjislacione, për të siguruar që KKK merr përgjigje të arsyetuar, siç përcaktohet me nenin 24 të Statutit të KKK;
- Të sigurohet që projektligji shpërndahet tek të gjithë anëtarët e KKK–së në kohë të duhur, për të mundësuar rishikim adekuat dhe hartim të komenteve;
- Të sigurohet zbatim adekuat i procedurave të akreditimit dhe emërimit (siç është përcaktuar në nenin 13.2.3 të Statutit), duke përfshirë masa për promovimin dhe shpërndarjen publike të informatave mbi procesin e akreditimit për regjistrimin e shoqatave dhe organizatave joqeveritare të komuniteteve me qëllim të rritjes së numrit të organizatave dhe shoqatave të akredituara dhe rrjedhimisht duke rritur përfaqësimin e komuniteteve, veçanërisht duke inkurajuar gratë;
- Të mbështeten kapacitetet e KKK–së për të komentuar mbi projekt–legjislacionin (siç përcaktohet në nenin 13.2.6 të Statutit), duke organizuar ngritje të kapaciteteve për anëtarët e rinj të KKK–së, përfshirë mbi mënyrat e komentimit në projektligje, duke përfshirë një komponentë për legjislacionin e ndjeshëm gjinor për të rritur kapacitetin për burrat dhe gratë që të jenë në gjendje të integrojnë perspektivën gjinore në proces;
- Të mbështeten aktivitetet e kontaktimit në terren dhe të promovohet dukshmëria e KKK–së, siç përcaktohet në nenin 13.2.5 të Statutit.

Për anëtarët e KKK–së

- Të ndërmerren aktivitete të rregullta të kontaktit në terren dhe vetëdijesimit në komunat ku jeton një numër i konsiderueshëm i pjesëtarëve të komuniteteve në pakicë numerike, mbi rolin dhe përgjegjësitë e KKK–së, duke siguruar gjithashtu që aktivitetet e tilla i targetojnë burrat dhe edhe gratë dhe të sigurohet që konsideratat gjinore janë komponentë e rëndësishme e planifikimit fillestar;
- Të sigurohet që komentet për projekt–legjislacion të bëhen dhe të dorëzohen në kohën e duhur.

Për institucionet që kanë ulëse të përhershme në KKK

- Të caktohet një përfaqësues i përhershëm i institucionit në KKK;
- Të sigurohet pjesëmarrje dhe vijueshmëri e rregullt në mbledhjet e KKK–së.

Shtojca 1. Rekomandimet e dërguara për institucionet

Çështja/Ligji	Institucioni tek i cili është dërguar rekomandimi	Përgjigja nga institucioni	Vlerësimi i KKK për përfundimin	A është marrë parasysh rekomandimi nga institucioni?	Veprimet e ndërmarra nga institucioni
Lëshimi i dokumenteve të gjendjes civile/të drejtat gjuhësore (nuk ka formular për lëshimin e dokumenteve në turqisht dhe boshnjakisht në komunat ku gjuha është gjuhë zyrtare në nivel lokal).	Agjencia e Regjistrimit Civil	X	Agjencia e Regjistrimit Civil ka ndërmarrë veprimet e duhura dhe gjatë vitit 2015 ka ofruar zgjidhje për çështjen e trajtuar me rekomandim të Këshillit.	✓	Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) ka mbledhur grupin punues më 5 qershor 2015, ku janë analizuar të gjithë formularët dhe dokumentet që kanë të bëjnë me regjistrimin civil. Zbrazëtitrat e identifikuar janë rregulluar dhe modifikuar në sistemin kompjuterik që lëshon të gjithë formularët për letërnjoftime, në përputhje me rekomandimet e KKK-së.
Punësimi i pjesëtarëve të komuniteteve joshumicë në shërbimin civil/zbatimi i Ligjit për Shërbimin Civil (që rregullon përfaqësimin e komuniteteve në pakicë numerike në shërbimin civil në nivel qendror).	Ministria e Integrimit Evropian	X	Nuk është bërë asnjë përmirësim nga ministritë	X	Nuk është ndërmarr asnjë veprim
	Ministria e Drejtësisë	X		<i>Në pritje të informatave</i>	<i>Në pritje të informatave</i>
	Ministria e Zhvillimit Ekonomik	X		✓	Ministria ka angazhuar 18 pjesëmarrës nga komunitetet joshumicë në vitin 2016
	Ministria e Financave	✓		<i>Në pritje të informatave</i>	<i>Në pritje të informatave</i>
	Ministria e Punëve të Jashtme	X		<i>Në pritje të informatave</i>	<i>Në pritje të informatave</i>
	Ministria e Shëndetësisë	X		X	Nuk është ndërmarr asnjë veprim
	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë	✓		X	Nuk është ndërmarr asnjë veprim
Zbatimi i ligjit për përdorimin e gjuhëve në nivel komunal	Komuna e Prishtinës	X	Sipas informatave nga anëtarët e KKK-së, pas dorëzimit të rekomandimeve, komunat relevante kanë bërë përmirësime, por jo të mjaftueshme.	✓	Komuna ka ristrukturuar njësinë e përkthimit dhe komuna ka lëshuar udhëzime të qarta për mënyrën se si zyra duhet ta zbatojë ligjin për gjuhët për të siguruar përdorim të përhershëm të gjuhës serbe dhe turke. Veprimet e ndërmarra nga komuna ishin si në vijim: Përkthimi i të gjitha dokumenteve të komunës në gjuhën serbe, duke përfshirë edhe vendimet e kryetarit të komunës, të cilat nuk ishin përkthyer në të kaluarën. Përveç kësaj, përkthimi simultan është përmirësuar dhe ka përkthim të rregullt të faqes së internetit të komunës.

Zbatimi i ligjit për përdorimin e gjuhëve në nivel komunal	Komuna e Prizrenit	X	Sipas informatave nga anëtarët e KKK-së, pas dorëzimit të rekomandimeve, komunat relevante kanë bërë përmirësime, por jo të mjaftueshme.	✓	Zyra e protokollit të kryetarit të komunës tregoi se ata nuk iu kanë përgjigjur me shkrim rekomandimit të pranuar nga KKK-ja meqë që ata tashmë kanë ndërmarrë masat dhe veprimet e duhura, me qëllim që të sigurohen përdorimi i përhershëm i gjuhës turke dhe boshnjake.
	Komuna e Pejës	X		✓	Është angazhuar një përkthyes dhe janë përkthyer dokumentet zyrtare të komunës. Shumica e dokumenteve janë publikuar në faqen e internetit të komunës. Përkthimi është ofruar gjatë të gjitha takimeve zyrtare të komunës.
	Komuna e Mitrovicës Jugore	X		<i>Në pritje të informatave</i>	<i>Në pritje të informatave</i>
	Komuna e Gjilanit	X		X	Nuk është ndërmarr asnjë veprim
	Komuna e Vushtrrisë	X		X	Nuk është ndërmarr asnjë veprim
Shqyrtimi i hapësirës mediale në RTK për komunitetet gorane dhe kroate të Kosovës.	Bordi dhe Drejtori i RTK-së	X	Drejtori i RTK-së mori vendim për transmetimin e një programi për komunitetin goran dhe ka trajnuar dy pjesëtarë të stafit, por transmetimi i programit ende nuk ka filluar. Lidhur me komunitetin kroat, nuk është ndërmarrë asnjë veprim i dukshëm.	✓	Rekomandimet janë zbatuar veçanërisht në lidhje me komunitetin goran të Kosovës, ndërsa për komunitetin kroat të Kosovës procesi është në vazhdim e sipër.
Përdorimi i teksteve shkollore për studentët e komunitetit turk dhe boshnjak.	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë	X	Pavarësisht veprimeve të MASHT-it për furnizimin e nxënësve me tekste shkollore, ende mungojnë disa tekste shkollore për nxënësit e këtyre komuniteteve.	<i>Në pritje të informatave</i>	<i>Në pritje të informatave</i>
Kuotat për regjistrimin e studentëve nga komunitetet joshumicë në Universitetin e Prishtinës	Rektori i Universitetit të Prishtinës	X	MASHT-i ka lëshuar një Udhëzim Administrativ për aplikimin e masave afirmative.	X	Nuk është ndërmarr asnjë veprim
	Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë			<i>Në pritje të informatave</i>	<i>Në pritje të informatave</i>

PERFORMANCA
DHE NDIKIMI I
KËSHILLIT
KONSULTATIV PËR
KOMUNITETE

2015-2016